

**Propozimi i të gjitha OST-ve mbi Kërkesat
Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë (KORP) në lidhje
me Shkëmbimin e të Dhënave në përputhje me Nenin
40 (6) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të
datës 2 gusht 2017
Udhëzim për Operimin e Sistemit të Transmetimit të
Energjisë**

27/02/2018

PËRMBAJTJA

| | |
|----------------------------------------------------------------|----|
| KREU I..... | 5 |
| Dispozita të përgjithshme..... | 5 |
| Neni 1. Objekti dhe qëllimi..... | 5 |
| Neni 2. Përkufizimet..... | 6 |
| Neni 3. Përgjegjësitë kryesore | 7 |
| Neni 4. Konfidencialiteti | 8 |
| Neni 5. Aksesi në informacion | 8 |
| KREU 2..... | 9 |
| Kërkesat organizative kryesore, rolet dhe përgjegjësitë | 9 |
| Kapitulli 1 | 9 |
| Përgjegjësitë e OST-ve | 9 |
| Neni 6. Përgjegjësitë kryesore | 9 |
| Të dhëna Strukturore | 10 |
| Neni 7. Të dhëna strukturore të përdorura nga OST-të | 10 |
| Neni 8. Njoftimi i ndryshimeve..... | 10 |
| Të dhënat e Planifikuara..... | 11 |
| Neni 9. Përgjegjësitë e OST-ve..... | 11 |
| Të dhëna në kohë reale | 11 |
| Neni 10. Formati i informacionit në kohë reale | 11 |
| Kapitulli 2 | 12 |
| Përgjegjësitë e OSSH-ve..... | 12 |
| Të dhëna strukturore..... | 12 |
| Neni 11. Njoftimi i ndryshimeve..... | 12 |
| Të dhënat e skeduluara | 12 |
| Neni 12. Të drejtat dhe përgjegjësitë e OSSH-ve | 12 |
| Të dhënat në kohë reale | 13 |
| Neni 13. Të dhënat në kohe reale të siguruar nga OSSH-të..... | 13 |
| Kapitulli 3 | 13 |
| Përgjegjësitë e PRRR-ve..... | 13 |
| Të dhënat strukturore | 13 |
| Neni 14. Të dhënat strukturore të siguruar nga PRRR-të..... | 13 |
| Neni 15. Njoftimi i ndryshimeve..... | 14 |
| Të dhënat e skeduluara | 14 |
| Neni 16. Të dhënat e skeduluara të siguruar nga PRRR-të | 14 |
| Të dhënat në kohe reale | 14 |
| Neni 17. Të dhënat në kohë reale të siguruar nga PRRR-të..... | 14 |
| KREU 3..... | 15 |
| Dispozita përfundimtare | 15 |
| Neni 18. Data e implementimit të KORP | 15 |
| Neni 19. Gjuha | 15 |

Të gjithë OST-të, duke patur parasysh si më poshtë që:

1. Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit (referuar këtu e tutje si "OST-të") në lidhje me kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë kryesore mbi shkëmbimin e të dhënave (referuar këtu e tutje si "KORP").
2. KORP merr parasysh parimet dhe qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren e Komisionit të (BE) 2017/1485 Për krijimin e një Udhëzuesi mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë (referuar këtej e tutje si "SO GL"), në Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 Për krijimin e një udhëzuesi mbi Alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e Konxhestioneve (referuar këtej e tutje si "CACM"), si dhe në Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/2195, Mbi krijimin e një Udhëzuesi për balancimin e energjisë (referuar këtej e tutje si EB GL). Qëllimi i SO GL është të ruajë sigurinë operacionale, cilësinë e frekuencës dhe përdorimin efikas të sistemit dhe burimeve të interkonektuara. Për të arritur këto synime, është e nevojshme që secila palë e sistemit elektrik të ketë vëzhgueshmërinë e nevojshme të elementeve të rrjetit dhe të shërbimeve që ndikojnë në operimin e tyre. Veçanërisht e rëndësishme është balanca globale gjenerim-kërkesë nëpërmjet prokurimit të shërbimeve balancuese dhe aktivizimit të ofertave të energjisë balancuese, ku EG BL ia cakton përgjegjësinë e balancimit OST-së . KORP trajton në veçanti rolet kryesore, kërkesat dhe përgjegjësitë e OST-ve, operatorëve të sistemit të shpërndarjes (referuar këtej e tutje si OSSh-të), operatorëve të sistemit të mbyllur të shpërndarjes (referuar këtej e tutje si "OSMSh ose en-CDSOs" dhe Përdoruesve të Rëndësishëm të Rrjetit (referuar këtej e tutje si PRRR ose eng-SGUs") në lidhje me shkëmbimin e të dhënave të nevojshme për të siguruar këtë vëzhgueshmëri.
3. KORP merr parasysh dhe plotëson aty ku është e nevojshme kushtet dhe kërkesat operacionale të përcaktuara në metodologjinë e sigurimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës (referuar këtej e tutje si "GL DPM") të hartuara në përputhje me nenin 16 të CACM. Ndërsa GLDPM përcakton se cilat të dhëna duhet të sigurohen nga kush dhe kur përgatitet modeli i rrjetit të përbashkët, KORP adreson se kush, si, dhe kur kryhen detyrat e përcaktuara në SO GL lidhur me shkëmbimin e të dhënave. Për më tepër, GL DPM i referohet vetëm shkëmbimit të dhënave deri në ditën D-1, ndërsa KORP gjithashtu përfshin shkëmbimin e të dhënave deri në kohë reale.

Neni 40 (6) i SO GL përcakton bazën ligjore të KORP dhe liston elementet që mbulohen nga KORP:

6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë OST-të do të pajtohen bashkërisht mbi kërkesat kryesore të organizimit, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave. Këto kërkesa organizative, rolet dhe përgjegjësitë duhet të marrin parasysh dhe plotësojnë aty ku është e nevojshme kushtet operative të metodologjisë së të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës të hartuar në përputhje me Nenin 16 të Rregullores (EU) Nr. 2015/1222. Ato do të aplikohen në të gjitha dispozitat mbi shkëmbimin e të dhënave në këtë Titull dhe do të përfshijnë kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë për elementet e mëposhtëm:

- a) *detyrimet për OST-të për të komunikuar pa vonesë me të gjitha OST-të fqinje mbi çdo ndryshim në parametrat e mbrojtjes, kufijtë termikë dhe kapacitetet teknike në interkonektorët ndërmjet zonave të tyre të kontrollit;*
- b) *detyrimet për OSSh-të e lidhura direkt me sistemin e transmetimit për të informuar OST-të e tyre, brenda afateve të rëna dakord, për çdo ndryshim në të dhënat dhe informacionin në përputhje me këtë Titull;*
- c) *detyrimet për OSSh-të fqinje dhe/ose ndërmjet OSSh-së downstream dhe upstream, për të informuar njëri-tjetrin brenda afateve të rëna dakord, për çdo ndryshim në të dhënat dhe informacionin e përcaktuar në përputhje me këtë Titull;*
- d) *detyrimet për PRRR-të për të informuar OST-në ose OSSH-në, brenda afateve të rëna dakord, për çdo ndryshim të rëndësishëm në të dhënat dhe informacionin e përcaktuar në përputhje me këtë Titull;*

- e) përmbajtjen e detajuar e të dhënave dhe informacionit të përcaktuar në përputhje me këtë Titull duke përfshirë parimet kryesore, llojin e të dhënave, mjetet e komunikimit, formatin dhe standardet që duhet të zbatohen, kohën dhe përgjegjësitë;
- f) kohën e përcaktuar dhe frekuencën e shpërndarjes së të dhënave dhe informacionit që do të sigurohet nga OSSH-të dhe PRRR-të, që do të përdoren nga OST-të në afate të ndryshme kohore. Duhet përcaktuar frekuenca e shkëmbimit të informacionit për të dhënat në kohë reale, të dhënat e planifikuara dhe përditësimin e të dhënave strukturore; dhe
- g) formatin për raportimin e të dhënave dhe informacionit të përcaktuar në përputhje me këtë Titull. Nga ENTSO-E do të publikohen Kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë .
5. Neni 40 (5) i SO GL specifikon se, OST do të përcaktojë, në koordinim me OSSH-të dhe PRRR-të, zbatueshmërinë dhe fushëveprimin e shkëmbimit të të dhënave në bazë të kategorive a) deri d) të nenit 40 (5) duke iu referuar neneve specifike të Kreut II të SO GL. Si pasojë, zbatimi duhet të përcaktohet në nivel kombëtar dhe i nënshtrohet miratimit nga autoriteti kompetent (Autoriteti Kombëtar Rregullator ose ndonjë subjekt tjetër i caktuar nga Shteti Anëtar).
 6. Neni 40 (7) i SO GL specifikon detyrimin e OST-ve për të rënë dakord me OSSH-të respektive në procesin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre, duke përfshirë formatin e shkëmbimit të të dhënave.
 7. KORP do të sigurojë ofrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e analizës së sigurisë në përputhje me nenin 75 të SO GL i cili specifikon detyrimin e OST-ve për të hartuar një metodologji për analizën e sigurisë operacionale të koordinuar.
 8. Neni 40 (10) i SO GL i jep të drejtën OSSH-ve me pikë lidhjeje në një sistem transmetimi për të marrë informacionin përkatës strukturor, të planifikuar dhe në kohë reale nga OST-të respektive si dhe për të mbledhur informacionin përkatës strukturor, të skeduluar dhe në kohë reale nga OSSH-të fqinje. Ai gjithashtu specifikon detyrimin e OSSH-ve fqinje për të përcaktuar në mënyrë të koordinuar fushën e informacionit të shkëmbyer ndërmjet tyre dhe OST-në përkatëse.
 9. Neni 6 (6) i SO GL kërkon përcaktimin e afatit kohor të propozuar të implementimit dhe një përshkrim të ndikimit të pritshëm të KORP në objektivat e SO GL.
 10. Me tej KORP përcakton një kuadër të përbashkët për shkëmbimin e të dhënave për të gjithë OST-të në sistemin e interkonektuar, në përputhje me kërkesat e nenit 4 (1) (a) të SO GL.
 11. Me qëllim përcaktimit e parimeve të përbashkëta të planifikimit operativ siç kërkohet në nenin 4 (1) (b) të SO GL, KORP lejon marrjen e të dhënave të nevojshme për përgatitjen e skenarëve për të kryer analiza të sigurisë operative në fazën e planifikimit.
 12. KORP përfshin organizimin për të shkëmbyer, ndër të tjera, të dhëna në kohë reale dhe ofrimin e shërbimeve për të përcaktuar proceset e përbashkëta të kontrollit frekuencë-ngarkesë dhe strukturat e kontrollit siç kërkohet në nenin 4 (1) (c) të SO GL.
 13. Për të siguruar kushtet për ruajtjen e sigurisë operacionale në të gjithë Unionin siç është specifikuar në nenin 4 (1) (d) të SO GL, OST-të duhet të kenë vëzhgim të mirë të sistemit për të kryer analiza të besueshme të sigurisë. KORP synon të vendosë për OST-të kuadrin për të patur akses në të dhënat e nevojshme për zonën respektive të tyre të vëzhgimit dhe në përgatitjen e skenarëve të saktë.
 14. Shkëmbimet e të dhënave mbi aftësitë dhe prodhimin e energjisë aktive janë të nevojshme për OST-të që të ndjekin proceset e ruajtjes se një niveli cilësie të frekuencës për të gjitha zonat sinkrone në të gjithë Unionin siç përcaktohet në nenin 4 (1) (e) të SO GL.

15. KORP merr parasysh shkëmbimin e të dhënave strukturore dhe të planifikuara midis OST-ve dhe OSSh-ve për të kryer analiza të sigurisë para dhe në kohë reale, për të nxitur koordinimin e operimit të sistemit dhe planifikimit operativ siç përcaktohet në nenin 4 (1) (f) të SO GL.
16. Neni 4 (1) (g) i SO GL ka për qëllim sigurimin dhe rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së informacionit në lidhje me operimin e sistemit të transmetimit. KORP themelon strukturën për të rregulluar informacionin e nevojshëm ndërmjet palëve të ndryshme në sistemin elektrik për të garantuar sigurinë operationale.
17. KORP do të kontribuojë në operimin efikas dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit dhe të sektorit të energjisë elektrike në Union, duke pasur vëzhgim të mirë të sistemit për të kryer analiza të besueshme të sigurisë të cilat ndihmojnë në identifikimin e përmirësimeve në sistemin e transmetimit.
18. KORP kontribuon në objektivat e përgjithshme të SO GL në të mirë të të gjithë OST-ve, OSSh-ve, PRRR-ve, konsumatorëve, pjesëmarrësve të tregut, Agjencisë dhe autoriteteve rregullatore.

PARAQET KËRKESAT KRYESORE ORGANIZATIVE TË MEPOSHTME, ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË LIDHJE ME SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE TË GJITHA AUTORITETEVE RREGULLATORE:

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1. Objekti dhe qëllimi

1. KORP siç është përcaktuar në këtë dokument konsiderohet si propozim i përbashkët i të gjitha OST-ve në përputhje me nenin 40 (6) të SO GL dhe do të përfshijë kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë për shkëmbimin e të dhënave sipas Kreut II të kësaj rregulloreje .
2. KORP do të zbatohet në të gjitha sistemet e transmetimit, sistemet e shpërndarjes dhe interkonektoret në Union, në zonën e përmendur në nenin 2 (2) të SO GL.
3. KORP do të zbatohet në PRRR-të, siç referohet në Nenin 2 (1) të SO GL. PRRR-të që ofrojnë shërbime në sistem individualisht ose përmes një agregatori duhet të jenë në përputhje me rregullat e parakualifikimit të përcaktuara në nivel kombëtar. Rolet dhe përgjegjësitë e një agregatori do të përcaktohen në marrëveshjet përkatëse të ofrimit të shërbimit në zbatim të rregullave kombëtare të parakualifikimit.
4. KORP do të zbatohet në:
 - a) OSMSH-të në rolin e tyre si operatorë të sistemit përkatës. Për qëllime të KORP, OSMSH-të do të konsiderohen si OSSh, siç përcaktohet në nenin 3 (1) të Rregullores së Komisionit (KE)1388/2016 mbi themelimin e një Kodi të Rrjetit mbi Lidhjen e Kërkesës (këtej e tutje si "NC DCC"). Kërkesat dhe përgjegjësitë e përshkruara do të zbatohen në përputhje me rrethanat.
 - b) OSMSH-të e lidhura me transmetimin në rolet e tyre si PRRR në përputhje me nenin 2 (1) të SO GL dhe nëse përcaktohen në nivel kombëtar brenda zbatueshmërisë dhe fushëveprimit të shkëmbimit të të dhënave që i nënshtrohen KORP.
5. Kur zbaton KORP, operatorët e sistemit duhet të :
 - a) zbatojnë parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit;

- b) sigurojnë transparence;
 - c) të zbatojnë parimin e optimizimit midis efikasitetit më të lartë të përgjithshëm dhe kostos totale më të ulët për të gjitha palët e përfshira;
 - d) respektojnë përgjegjësinë e caktuar për OST-në përkatëse për të garantuar sigurinë e sistemit, siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar;
 - e) të konsultohen me OSSh-të përkatëse dhe të marrin parasysh ndikimet e mundshme në sistemin e tyre;
 - f) ndjekin, marrin në konsiderate standartet Evropiane dhe specifikimet teknike
6. OST-te jashtë juridiksionit të zonës së përmendur në nenin 2 (2) të SO GL-së, mund të miratojnë KORP-in në baza vullnetare, me kusht që:
- a) Për ta bërë këtë është teknikisht e mundshme dhe në përputhje me kërkesat e SO GL;
 - b) Ata bien dakord që do të kenë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi në lidhje me procesin e shkëmbimit të të dhënave si OST të përmendura në paragrafin 2, në veçanti, ata do të pranojnë që KORP zbatohet edhe për palët respektive në zonën e tyre të kontrollit;
 - c) Ata pranojnë çdo kusht tjetër ligjërish të mundshëm që lidhet me natyrën vullnetare të pjesëmarrjes së tyre në procesin e shkëmbimit të të dhënave që mund të vendosin OST-të;
 - d) OST-të e përmendura në paragrafin 2 kanë lidhur marrëveshje që rregullon kushtet e pjesëmarrjes vullnetare me OST-të e përmendura në këtë paragraf;
 - e) Pasi OST-të që marrin pjesë në procesin e shkëmbimit të të dhënave në baza vullnetare kanë demonstruar pajtueshmëri objektive me kërkesat e parashtruara në (a), (b), (c) dhe (d) të këtij paragrafi, OST-të e përmendura në paragrafin 1, pasi të verifikojnë se kriteret në (a), (b), (c) dhe (d) janë plotësuar, kanë aprovuar aplikimin nga OST që dëshiron të bashkohet në procesin e KORP në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 5 (3) e SO GL.
7. OST-të e përmendura në paragrafin 2 do të monitorojnë nëse OST-të që marrin pjesë në procesin e shkëmbimit të të dhënave në baza vullnetare në përputhje me paragrafin 6, i respektojnë detyrimet e tyre. Nëse një OST që merr pjesë në procesin e shkëmbimit të të dhënave në përputhje me paragrafin 6, neglizhon detyrimet e tij themelore në mënyrën që rrezikon potencialisht zbatimin dhe funksionimin e SO GL, OST-të e përmendura në paragrafin 2 do të ndërpresin marrëveshjen e pjesëmarrjes vullnetare të OST-së në procesin e shkëmbimit të të dhënave në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 5 (3) të SO GL.

Neni 2. Përkufizimet

1. Për qëllimet e KORP-it, termat e përdorur në këtë dokument do të kenë kuptimin e përkufizimeve të përfshira në nenin 3 të SO GL, nenin 2 të CACM, nenin 2 të EB GL, nenin 2 të Rregullores (KE) 714 / 2009 Mbi kushtet për qasje në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 543/2013 mbi paraqitjen dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë elektrike, nenin 2 të Rregullores së Komisionit (KE) 631/2016 mbi themelimin e një kodi të rrjetit për kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve (këtej e tutje referuar si "NC RfG"), nenin 2 të NC DCC, nenin 2 të Rregullores së Komisionit (KE) 1447/2016 mbi themelimin e kodit të rrjetit për kërkesat për lidhjen me rrjetin të moduleve të parkut të energjisë dhe sistemeve me rrymë të vazhduar me tension të lartë (këtej e tutje referuar si "NC HVDC"), si dhe nenin 2 të Direktivës 2009/72 / KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë si dhe në pika të tjera të legjislacionit të referuar aty.

2. KORP do të jetë i detyrueshëm për të gjitha OST-të, pasuesit dhe nënshkruesit e lejuar pavarësisht nga ndonjë ndryshim në emrat e OST-ve, si dhe mbi çdo subjekt tjetër që mbulon SO GL përfshirë OSSH-të dhe PRRR-të.
3. Në KORP, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe:
 - a) Njëjësi tregon shumësin dhe anasjelltas;
 - b) Tabela e përmbajtjes, titujt dhe shembujt futen vetëm për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e KORP;
 - c) Çdo referencë në legjislacion, rregullore, direktiva, rendin, instrumentin, kodin e rrjetit ose ndonjë akt tjetër duhet të përfshijë çdo modifikim, shtese ose ri-miratimin e tij dhe pastaj hyrjen në fuqi.
4. Për qëllime të KORP, një modifikim në elementin e rrjetit, modulën gjenerues të energjisë ose objektin e kërkesës, konsiderohet i rëndësishëm kur ai konsiderohet gjithashtu i rëndësishëm në NC RfG, NC DCC ose NC HVDC. Në këtë kontekst, në procesin e zbatimit në lidhje me përkufizimin e termit "i rëndësishëm", duhet të merren parasysh specifikat kombëtare.
5. Për qëllime të KORP-it, të dhëna në kohë reale nënkuptojnë një përfaqësim të gjendjes aktuale të moduleve gjeneruese të energjisë, objekteve të kërkesës ose elementëve të rrjetit të të dhënave të matjes.

Neni 3. Përgjegjësitë kryesore

1. Çdo OST, OSSH ose PRRR do të jetë përgjegjës për cilësinë e informacionit që jep në lidhje me modulet gjeneruese të tyre, objektet e kërkesës ose shërbimet për palët e tjera.
2. Në bazë të nenit 48 deri 50 dhe nenit 53 të SO GL, KORP përshkruan sigurimin e të dhënave për OST-të dhe OSSH-të si opsion të parazgjedhur. Në përputhje me nenin 40 (5) të SO GL, kjo metodologji mund të rishikohet në nivel kombëtar në mënyrë që t'iu lejojë PRRR-ve sigurimin e të dhënave vetëm për OST-në ose OSSH-në në të cilin ata janë të lidhur, përveç nëse kërkohet ndryshe për të ofruar shërbime në sistem. Në ato raste kur një PRRR jep vetëm të dhëna për një OST ose për një OSSH me të cilin ata janë të lidhur, OST dhe OSSH do të shpërndahen mes tyre të dhënat që lidhen me atë PRRR sipas proceseve të dakorduara sipas nenit 40 (7) të SO GL.
3. Në varësi të miratimit nga autoriteti rregullator kompetent ose nga subjekti i caktuar nga shteti anëtar, në përputhje me nenin 40 (5) të SO GL secili OST, në koordinim me OSSH-të në zonën e tij të kontrollit, do të përcaktojë nëse PRRR-të e lidhur në shpërndarje në zonën e tij të kontrollit do të sigurojnë të dhënat strukturore, të planifikuara dhe në kohë reale direkt tek OST ose nëpërmjet OSSH-së ku lidhet ose të të dyve njëkohësisht. Vendimi për çdo lloj informacioni dhe PRRR mund të jetë i pavarur. Kur të dhënat i ofrohen direkt OST-së, pas kërkesës së OSSH-së në rrjetin e të cilit është lidhur PRRR, OST do t'i vërë ato në dispozicion të OSSH-së. Kur të dhënat i ofrohen OSSH-së, OSSH-ja do t'i japë të dhënat OST-së. Cilësia dhe niveli i detajimit i të dhënave do të mirëmbahet ose përmirësohet.
4. Kur OST ose OSSH i marrin të dhënat direkt nga PRRR, OST ose OSSH do të kontrollojë që të dhënat janë në përputhje me kërkesat e cilësisë së specifikuar nga OST-të ose kur janë të zbatueshme nga OSSH-të sipas KORP-it përpara se ta ndajnë këtë informacion me një subjekt tjetër.

5. OSSH-të fqinje dhe/ose ndërmjet OSSH-ve downstream dhe OSSH-ve upstream informojnë njëri-tjetrin mbi proceset dhe formatet e çdo ndryshimi në të dhënat dhe informacionin midis tyre, në përputhje me nenin 40 (6) të SO GL.
6. OSSH-të do të jenë përgjegjës për instalimin, konfigurimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e lidhjeve të komunikimit për shkëmbimin e të dhënave me OST deri në pikën e ndërfaqes së komunikimit të dakorduar me OST.
7. PRRR-të që sigurojnë të dhëna të planifikuara për OST-në dhe PRRR-të që japin të dhëna në kohë reale sipas nenit 6 (5) të KORP do të jenë përgjegjës për instalimin, konfigurimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e lidhjeve të komunikimit për shkëmbimin e të dhënave deri në pikën e ndërfaqes së komunikimit me OST ose me OSSH kur të dhënat i ofrohen OSSH, përveç nëse në mënyrë eksplicite është rënë dakord ndryshe me OST ose OSSH.
8. OST ose OSSH, kur të dhënat i ofrohen drejtpërdrejt OSSH-së sipas nenit 3(3) të KORP, do të përcaktojnë pikën e ndërfaqes së komunikimit për shkëmbimin e të dhënave të planifikuara dhe të dhënave në kohë reale me PRRR-të.
9. Në varësi të marrëveshjes së OST ose OSSH-së në rastin kur PRRR-të sigurojnë të dhëna direkte për një OSSH, palët që iu kërkohet të japin të dhëna në kuadër të KORP do të lejohen të delegojnë të gjitha detyrat ose pjesë të saj të caktuara në SO GL në një ose më shumë palë të treta, në rast se pala e tretë mund të kryejë funksionin përkatës të paktën po aq efektivisht sa subjekti delegues. Subjekti delegues do të mbetet përgjegjës për sigurimin e pajtueshmërisë me detyrimet sipas SO GL, duke përfshirë sigurimin e qasjes në informacionin e nevojshëm për monitorim nga autoriteti rregullator.

Neni 4. Konfidencialiteti

1. Nëse në mënyrë eksplicite nuk shprehet ndryshe, të gjitha të dhënat e prekura nga KORP do të jenë konfidenciale. Në përputhje me nenin 12 të SO GL, secila palë që merr të dhëna sipas KORP-it duhet të zbatojë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar që të dhënat nuk i zbulohen ndonjë personi ose autoriteti tjetër, pa përjashtuar rastet e mbuluara nga ligji kombëtar, dispozitat tjera të SO GL ose legjislacioni tjetër përkatës i BE.
2. Duke iu nënshtruar detyrimit të konfidencialitetit të përcaktuar në nenin 12 të SO GL, OST-të mund të ndajnë të dhënat e përfutuara me të gjitha OST-të e tjera që kanë zbatuar plotësisht kërkesat e përcaktuara në KORP.

Neni 5. Aksesi në informacion

1. Çdo modul gjenerues i energjisë, objekt ngarkese ose OSSH e mbyllur e konsideruar si PRRR në përputhje me nenin 2 (1) të SO GL do të ketë qasje në informacionin strukturor referuar objekteve të tij, të ruajtura nga OST ose OSSH.
2. Çdo OSSH do të ketë qasje në informacionin strukturor, të planifikuar dhe në kohë reale të PRRR-ve të lidhur me rrjetin e tij të shpërndarjes.
3. Sipas nenit 40 (10) të SO GL, OSSH-të do të kenë qasje në informacionin strukturor, të planifikuar dhe në kohë reale të elementeve të komisionuar të rrjetit të transmetimit në pikën e tyre të lidhjes. Me justifikimin e nevojës për informacion për arsye të sigurisë operationale dhe simulime dinamike të

besueshme të rrjeteve të tyre, OSSH-të mund të kërkojnë informacion të mëtejshëm strukturor ose në kohë reale për elementët e rrjetit të komisionuar të sistemit të transmetimit të zonës së kontrollit ku janë të lidhur. Kur kërkesa për informacion vjen nga një CDSO, ai nuk do të përfshijë pikat e lidhjes së OSMSH-ve ose PRRR-ve të tjera. OST-të mund të japin përgjigje pozitive ose negative të justifikuara për këto kërkesa.

4. PRRR-të do të kenë qasje në informacionin strukturor, të planifikuar dhe në kohë reale të objekteve të komisionuara të sistemit të transmetimit ose të sistemit të shpërndarjes në pikën e tyre të lidhjes. Ai nuk duhet të përfshijë pikën e lidhjes së PRRR-ve të tjerë.
5. Autoritetet rregullatore kombëtare kompetente do të kenë qasje në të gjithë informacionet e shkëmbyera, të cilat i nënshtrohen KORP-it sipas kërkesës.
6. OST-të mund të ndajnë informacionin strukturor të OSSH-ve ose PRRR-ve me një palë të tretë për të përmbushur përgjegjësitë e përcaktuara në SO GL, në varësi të formalizimit, të konfidencialitetit dhe kufizimit të marrëveshjes së përdorimit.

KREU 2

Kërkesat organizative kryesore, rolet dhe përgjegjësitë

Kapitulli 1

Përgjegjësitë e OST-ve

Neni 6. Përgjegjësitë kryesore

1. Çdo OST duhet ti komunikojë OST-ve përkatëse, elementet e sistemit të tyre të transmetimit të identifikuar si pjesë e zonës së tij të observimit sipas metodologjisë në nenin 75 të SO GL.
2. Çdo OST do ti komunikojë OSSH-ve respektive të zonës së tij të kontrollit, elementet e rrjetit të tyre të shpërndarjes të identifikuar si pjesë e zonës së tij të observimit sipas metodologjisë në nenin 75 të SO GL.
3. Çdo OST do ti ofrojë informacion të përditësuar të elementeve të rrjetit në sistemin e tij të transmetimit që është pjesë e zonës së observimit të OST-së tjetër, në përputhje me nenin 41 dhe 42 (2) të SO GL.
4. Çdo OST do të shkëmbejë të dhëna në kohë reale me OST-të e tjera të zonës sinkrone në përputhje me nenin 42 (1) të SO GL.
5. Në varësi të miratimit nga autoriteti rregullator kompetent ose të miratimit nga entiteti i caktuar nga Shteti Anëtar në përputhje me nenin 40 (5) të SO GL, çdo OST, në koordinim me OSSH-të dhe PRRR-të, do të përcaktojë PRRR-të në zonën e tyre të observimit të cilat do të sigurojnë të dhëna në kohë reale.
6. Çdo OST do të sigurojë informacion të përditësuar të rrjetit të OSSH-së në zonës e tij të kontrollit që është pjesë e zonës së observimit e OST-së tjetër për ato OST.

7. Çdo OST mund të ofrojë informacion të përditësuar të rrjetit të OST-ve fqinje që kanë ndikim në rrjetin e shpërndarjes të zonës së vet të kontrollit, tek OSSh-të që operojnë këto rrjete të shpërndarjes.
8. Të gjitha të dhënat e transmetimit dhe të shpërndarjes që do të shkëmbehen ndërmjet zonave të kontrollit të OST-së, do të shkëmbehen vetëm nëpërmjet OST-ve, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga legjislacioni kombëtar ose marrëveshjet specifike.
9. Për të dhënat e kërkuara në përputhje me nenin 114, 115, 116 dhe 117 të SO GL, OST-të do të përdorin platformën e të dhënave të planifikimit operativ për shkëmbimin e informacionit strukturor dhe të planifikuar me OST-të e tjera. Të gjithë OST-të do të përdorin formatin e harmonizuar të të dhënave për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet tyre në përputhje me nenin 114 (2) të SO GL.
10. Çdo OST do të ruajë elektronikisht të dhënat e nevojshme për proceset e saj në kohëzgjatjen e përcaktuar sipas legjislacionin kombëtar.

Të dhëna Strukturore

Neni 7. Të dhëna strukturore të përdorura nga OST-të

1. Në marrëveshje me OSSh-të përkatëse, çdo OST do të specifikojë formatin dhe mund të publikojë formularët për të dhënat strukturore që OSSh-të duhet të sigurojnë. Formatin ose modelin duhet të përfshijë përmbajtjen e detajuar të të dhënave strukturore që duhet të jepen.
2. Çdo OST do të specifikojë formatin si dhe mund të publikojë formularë për të dhënat strukturore që duhet të sigurojnë PRRR-të e lidhur në transmetim dhe shpërndarje, që shkëmbejnë të dhëna direkt me OST-në. Formatin ose modelin duhet të përfshijë përmbajtjen e detajuar të të dhënave strukturore që duhet të sigurohen.

Neni 8. Njoftimi i ndryshimeve

1. Çdo OST duhet të shqyrtojë informacionin strukturor që ai shkëmben me OST-të e tjera së paku çdo 6 muaj si dhe të sigurojë informacion të përditësuar për zonën e observimit të OST-së fqinje në situatat e mëposhtme:
 - a) Së paku 6 muaj para komisionit të planifikuar të një elementi të ri të rrjetit, moduli gjenerues të energjisë ose objekti kërkese;
 - b) Së paku 6 muaj para heqjes përfundimtare nga shërbimi i elementit të rrjetit, të planifikuar, të një moduli gjenerues të energjisë ose objekti kërkese;
 - c) Së paku 6 muaj para ndryshimeve të rëndësishme në elementin e rrjetit, të modulit gjenerues të energjisë ose objektit të kërkesës, të planifikuar;
 - d) Sa më shpejt që të jetë e mundur në rast se ka një ndryshim në zonën e observimit;
 - e) Sapo të zbulohet një gabim në grupin e të dhënave të shkëmbyera më herët.
2. Në përputhje me nenin 5 (3) dhe nenin 5 (4), OSSh-të dhe PRRR-të mund të kërkojnë përditësimin e të dhënave strukturore nga OST-ja e tyre.

Të dhënat e Planifikuara

Neni 9. Përgjegjësitë e OST-ve

1. Çdo OST duhet të jetë në gjendje të shkëmbejë të dhënat e planifikuara me OST-të dhe me PRRR-të, OSSh-të ose palët e treta në zonën e tij të observimit të cilëve mund t'ju jetë deleguar shkëmbimi i informacionit të planifikuar. Të dhënat e planifikuara duhet të përfshijnë së paku skedulet e prodhimit dhe të konsumit midis dy ditëve përpara dhe afër kohës reale, pa-disponueshmërinë ose kufizimet e prodhimit të fuqisë aktive ose konsumit të PRRR-ve dhe pa-disponueshmërinë e elementëve të rrjetit në zonën e observimit të OST-së.
2. Në marrëveshje me OSSh-të brenda zonës së kontrollit të OST-së, çdo OST do të specifikojë formatin dhe mund të publikojë formularë për të dhënat e skeduluara të planifikuara për t'u shkëmbyer mes tyre.
3. Në koordinim me PRRR-të ose palët e treta në zonën e kontrollit të OST-së, çdo OST do të përcaktojë dhe publikojë formatin e informacionit për shkëmbimin e të dhënave të planifikuara.
4. Çdo OST do të përcaktojë dhe publikojë kërkesat teknike, duke përfshirë periudhën e kohës së vendosur për shkëmbimin e të dhënave të skeduluara me PRRR-të, OSSh-të ose palët e treta brenda zonës së tij të kontrollit. Kërkesat teknike, kur është e mundur, duhet të jenë në përputhje me një standard ndërkombëtar të rekomanduar nga të gjithë OST-të dhe me teknologjitë e tanishme për të garantuar sigurinë, konfidencialitetin dhe redundancën e komunikimeve.
5. Çdo OST do t'i komunikojë OSSh-ve të lidhura me sistemin e transmetimit pa-disponueshmërinë e tyre të planifikuar dhe të paplanifikuar për elementët e rrjetit në pikën e tyre të lidhjes. Për pa-disponueshmërinë e planifikuar, ata do të bien dakord mbi nivelin e nevojshëm të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet tyre. Për pa-disponueshmërinë e paplanifikuar, OST do t'ua komunikojë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Të dhëna në kohë reale

Neni 10. Formati i informacionit në kohë reale

1. Çdo OST, në marrëveshje me OSSh-të në zonën e tij të kontrollit, duhet të specifikojë përmbajtjen e hollësishme dhe të publikojë formatin për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale ndërmjet tyre lidhur me zonën e observimit të rrjetit të shpërndarjes brenda zonës së tij të kontrollit.
2. Çdo OST, në koordinim me PRRR-të dhe OSSh-të, duhet të specifikojë përmbajtjen e detajuar dhe të publikojë formatin për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në lidhje me PRRR-të brenda zonës së tij të kontrollit.
3. Çdo OST duhet të specifikojë kërkesat teknike, duke përfshirë periudhat e kohës, për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale lidhur me zonën e vëzhgimit të rrjetit të shpërndarës dhe PRRR-ve brenda zonës së tij të kontrollit. Kërkesat teknike, kur është e mundur, duhet të jenë në përputhje me një standard ndërkombëtar të rekomanduar nga të gjithë OST-të dhe me teknologjitë aktuale për të garantuar siguri, konfidencialitet dhe redundancë të komunikimeve.
4. Çdo OST, kur shkëmben informacion në kohë reale me OST-të tjera, do të ndjekë dhe përmbushë të gjitha rregullat dhe detyrimet sipas praktikave aktuale të të gjitha OST-ve në terma të:

- a) Lidhjeve logjike ndërmjet palëve dhe protokolleve të përdorura;
 - b) Arkitekturën e rrjetit duke përfshirë redundancën;
 - c) Rregullat e sigurisë së rrjetit;
 - d) Kodin e identifikimit(ID) dhe/ose emrin e marrëveshjes dhe cilësinë e të dhënave;
 - e) Të dhënat e parametrave dhe performancës së transmetimit;
 - f) Rregullat e sjelljes në rast të ndërprerjeve të planifikuara dhe defekteve në pajisjet e komunikimit.
1. Çdo OST do të përcaktojë shkallën e rifreskimit të të dhënave për shkëmbimet e të dhënave në kohë reale në zonën e tij të kontrollit. Shkalla nuk duhet të jetë më e gjatë se 1 minutë.

Kapitulli 2

Përgjegjësitë e OSSH-ve

Të dhëna strukturore

Neni 11. Njoftimi i ndryshimeve

1. Çdo OSSH do të shqyrtojë informacionin strukturor të elementëve të rrjetit në zonën e observimit , moduleve gjeneruese të energjisë dhe objekteve të Kërkesës në zonën e kontrollit që ai ndan me OST-të së paku çdo 6 muaj dhe, në marrëveshje me OST, ti sigurojë informacion të përditësuar OST-së në situatat e mëposhtme:
- a) Të paktën 6 muaj, para komisionimit të planifikuar të instalimit të një elementi të ri të rrjetit, të një moduli gjenerues të energjisë ose objekti të Kërkesës.
 - b) Së paku 6 muaj para heqjes së planifikuar përfundimtare nga shërbimi i elementit të rrjetit, i një moduli gjenerues të energjisë ose objekti Kërkesë ;
 - c) Së paku 6 muaj para modifikimeve të rëndësishme të planifikuara, në elementin e rrjetit, në modulin gjenerues të energjisë ose objektin e Kërkesës ;
 - d) Sa më shpejt që të jetë e mundur në rast se ka një ndryshim në Zonën e Observimit;
 - e) Sapo të zbulohet një gabim në grupin e të dhënave të shkëmbyera më herët.
2. Çdo OSSH, në koordinim me OST-në e tij, duhet të specifikojë formatin dhe mund të publikojë modele për të dhënat strukturore, të cilat duhet të sigurohen nga PRRR-të e lidhur në shpërndarje që shkëmbejnë të dhëna me OSSH-në drejtpërsëdrejti. Formatin ose modelin duhet të përfshijë përmbajtjen e detajuar të të dhënave strukturore që duhet të sigurohen.
3. Në përputhje me nenin 5 (4), PRRR-të e lidhur në nivelin e shpërndarjes mund të kërkojnë përditësimin e të dhënave strukturore nga OSSH-ja e tij.

Të dhënat e skeduluara

Neni 12. Të drejtat dhe përgjegjësitë e OSSH-ve

1. Të gjithë OSSh-të brenda zonës së observimit të OST-së respektive do të sigurojnë OST-së pa-disponueshmërinë e planifikuar të elementeve të rrjetit, së paku në D-2 dhe D-1 dhe papajtueshmërinë e tyre të paplanifikuar sa më shpejt që të jetë e mundur. Për pa-disponueshmërinë e planifikuar, ata do të bien dakord mbi nivelin e nevojshëm të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet tyre. OSSh-të e lidhura me transmetimin do të sigurojnë të dhëna direkt në OST. OSSh-të e lidhura jo-direkt me transmetimin mund të sigurojnë të dhëna drejtpërdrejt në OST ose përmes OSSh-së së tij lidhëse ose të dyve, siç përcaktohet në nenin 3 (3). Frekuenca e shpërndarjes së të dhënave të planifikuara do të përcaktohet në nivel kombëtar.
2. Çdo OSSh do të ketë qasje në të dhënat e planifikuara të PRRR-ve të lidhura me rrjetin e tij. OSSh-të duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga OST respektive për shkëmbimin e të dhënave të planifikuara

Të dhënat në kohë reale

Neni 13. Të dhënat në kohe reale të siguruara nga OSSh-të

1. Çdo OSSh duhet të sigurojë për OST-në të dhënat në kohë reale nga zona e observimit e përcaktuar nga OST sipas nenit 44 të SO GL.
2. Çdo OSSh duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara nga OST-ja në terma të:
 - a) Lidhjeve logjike ndërmjet palëve dhe protokolleve të përdorura;
 - b) Arkitekturën e rrjetit duke përfshirë redundancën;
 - c) Rregullat e sigurisë së rrjetit;
 - d) Kodin e identifikimit(ID) dhe/ose emrin e marrëveshjes dhe cilësinë e të dhënave;
 - e) Të dhënat e parametrave dhe performancës së transmetimit;
 - f) Rregullat e sjelljes në rast të ndërprerjeve të planifikuara dhe defekteve në pajisjet e komunikimit.
3. Çdo OSSh, në koordinim me OST-në e tij dhe PRRR-të, duhet të specifikojë përmbajtjen e hollësishme dhe kërkesat për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale lidhur me PRRR-të e lidhura në shpërndarje që shkëmbejnë të dhëna direkt me OSSh-në. Kërkesat teknike, kur është e mundur, duhet të jenë në përputhje me një standard ndërkombëtar të rekomanduar nga të gjithë OST-të dhe me teknologjitë aktuale për të garantuar siguri, konfidencialitet dhe redundancë të komunikimeve. Çdo OSSh duhet të sigurojë formatet dhe formularët për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale nga PRRR-të.

Kapitulli 3

Përgjegjësitë e PRRR-ve

Të dhënat strukturore

Neni 14. Të dhënat strukturore të siguar nga PRRR-të

1. Çdo PRRR e lidhur me sistemin e transmetimit do t'i sigurojë OST-së së tij, në formatin e specifikuar nga OST, të dhënat strukturore në përputhje me nenin 45 dhe 52 (1) të SO GL.
2. Çdo PRRR e lidhur me sistemin e shpërndarjes duhet të sigurojë drejtpërsëdrejti OST-së ose nëpërmjet OSSH-së që e lidh atë ose në të dyjave njëkohësisht , të dhënat strukturore në përputhje me nenet 48 dhe 53 të SO GL, në formatin e specifikuar nga OST-ë ose OSSH-ë, siç përcaktohet në nenin 3 (3).

Neni 15. Njoftimi i ndryshimeve

1. Çdo PRRR do të shqyrtojë informacionin strukturor që ai ndan me OSSH-të ose OST-të e zonës së kontrollit të cilës i përket PRRR, të paktën çdo 6 muaj dhe të sigurojë informacion të përditësuar për OST dhe OSSH në kushtet e mëposhtme:
 - a) Të paktën 6 muaj, para komisionimit të planifikuar, të instalimit të një elementi të ri të rrjetit, të një moduli gjenerues të energjisë ose objekti të Kërkesës .
 - b) Së paku 6 muaj para heqjes së planifikuar përfundimtare nga shërbimi i elementit të rrjetit, të një moduli gjenerues të energjisë ose objekti Kërkese;
 - c) Së paku 6 muaj para modifikimeve të rëndësishme në elementin e rrjetit të planifikuar në moduln gjenerues të energjisë ose objekti Kërkese;
 - d) Sapo të zbulohet një gabim në grupin e të dhënave të shkëmbyera më herët.
 - e) Në rastin e një modifikimi të pa-parashikuar brenda periudhës prej 6 muajsh para datës së hyrjes në fuqi të situatës së re të përshkruar në pikat a, b dhe c, PRRR-ja do të informojë pa vonesë OST-në.

Të dhënat e skeduluara

Neni 16. Të dhënat e skeduluara të siguruar nga PRRR-të

1. Të gjitha PRRR-të brenda zonës së kontrollit të OST do të sigurojnë të dhëna të skeduluara për OST-në. PRRR-të e lidhur në Transmetim duhet të sigurojnë të dhëna drejtpërsëdrejti në OST. PRRR-të e lidhur në shpërndarje duhet të sigurojnë të dhëna drejtpërsëdrejti në OST ose nëpërmjet OSSH-së me të cilën janë të lidhur ose për të dyja, siç përcaktohet në nenin 3 (3).
2. Për shkëmbimin e të dhënave të planifikuara, PRRR-të duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga OST respektive ose nga OSSH kur të dhënat shkëmbehen përmes OSSH-së. Frekuenca e shpërndarjes së të dhënave të planifikuara do të përcaktohet në nivel kombëtar.

Të dhënat në kohë reale

Neni 17. Të dhënat në kohë reale të siguruar nga PRRR-të

1. Në bazë të nenit 6 (5) të KORP, të gjitha PRRR-të respektive të lidhura me sistemin e transmetimit duhet t'i sigurojnë direkt OST-së të dhëna në kohë reale. Në bazë të nenit 6 (5) të KORP, të gjitha PRRR-

të respektive të lidhura në shpërndarje duhet të sigurojnë të dhëna në kohë reale për OST-në ose nëpërmjet OSSH-së që e lidh atë ose nga të dy, siç përcaktohet në nenin 3 (3). Të gjitha PRRR-të që janë module gjenerimi të energjisë që nuk i nënshtrohen NC RfG ose që janë sisteme HVDC që nuk i nënshtrohen HVDC NC ose që janë objekte të Kërkesës që nuk i nënshtrohen NCC DC, duhet të informojnë OST-në për të dhënat në kohë reale të aftësive të tyre teknike. Procesi i vlerësimit për të përjashtuar PRRR të veçanta, në rast të mosrespektimit të detyrimit për të siguruar të dhëna në kohë reale, do të përcaktohet në nivel kombëtar.

2. Çdo PRRR që siguron të dhëna direkt për OST-në ose OSSH-në, kur të dhënat i ofrohen drejtpërdrejt OSSH-së, duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara nga OST në terma të:

- a) Lidhjeve logjike ndërmjet palëve dhe protokolleve të përdorura;
- b) Arkitekturën e rrjetit duke përfshirë redundancën;
- c) Rregullat e sigurisë së rrjetit;
- d) Kodin e identifikimit (ID) dhe/ose emrin e marrëveshjes dhe cilësinë e të dhënave;
- e) Të dhënat e parametrave dhe performancës së transmetimit;
- f) Rregullat e sjelljes në rast të ndërprerjeve të planifikuara dhe defekteve në pajisjet e komunikimit.

KREU 3

Dispozita përfundimtare

Neni 18. Data e implementimit të KORP

1. M
e miratimit të KORP-it, çdo OST do ta publikojë atë në internet në përputhje me nenin 8 (1) të SO GL.
2. De
ri 18 muaj pas hyrjes në fuqi të SO GL dhe në përputhje me nenin 192 të SO GL, OST-të do të zbatojnë KORP siç përshkruhet në Kreun II, sapo të gjitha autoritetet rregullatore ta kenë miratuar KORP ose është marrë nga Agjencia një vendim në përputhje me nenin 6 (8) dhe 7 (3) të SO GL.

Neni 19. Gjuha

Gjuha e referencës për KORP do të jetë gjuha angleze. Për shmangien e dyshimit, ku OST-të duhet ta përkthejnë KORP në gjuhën(t) e tij(tyre) kombëtare, në rast të mospërputhjeve midis versionit anglisht të botuar nga OST-të, në përputhje me nenin 8 (1) të SO GL dhe çdo versioni në një gjuhë tjetër, OST-të në përputhje me legjislacionin kombëtar, do t'u ofrojnë autoriteteve përkatëse kombëtare rregullatore përkthimin e përditësuar të KORP-it.